



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2022
Nr. Dok.202200148/12

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave të nevojshme nga punonjësit e Inspektoratit për Mbrojtjen e Territorit pranë Bashkisë Tiranë dhe nga strukturat e Policisë Bashkiake për të respektuar dhe garantuar të drejtën e ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve nga gazetarët e pranishëm gjatë prishjeve të banesave, protestave apo aktiviteteve të tjera të kësaj natyre*

**BASHKISË TIRANË
INSPEKTORATIT PËR MBROJTJEN E TERRITORIT TIRANË
POLICISË BASHKIAKE
TIRANË**

Të nderuar,

Sikurse ju kemi informuar, në institucionin e Avokatit të Popullit ka nisur ndjekja me iniciativë e rastit të bërë publik në media, në mëngjesin e 9 shkurtit në lagjen "5 Maji", gjatë prishjes së banesave nga Bashkia Tiranë dhe strukturat e varësisë.

Fillimisht, në media ka qarkulluar lajmi se përveç banorëve, forcat e policisë kanë larguar me forcë gazetaren e Ora News, S.M e cila ishte duke raportuar live ngjarjen nga terreni.

"Me tensione të shumta është shoqëruar situata në lagjen "5 Maji" mëngjesin e 9 shkurtit 2022.

Përveç banorëve, forcat e policisë kanë larguar me forcë gazetaren e Ora News, S.M e cila ishte duke raportuar live ngjarjen.

Edhe pse gazetarja nuk ka ndërhyrë në asnjë moment efektivët i kërkojnë të largohet, duke e penguar të ushtrorë detyrën.

"Punonjësi i policisë bashkiake i cili paguhet nga taksat e mia, duke ushtruar dhunë ndaj një femre mbi të gjitha e cila është në krye të detyrës. I thashë më lini se do dal vetë. Të gjithë këta që paguhet nga taksat tona, unë isha në krye të detyrës dhe interesi ynë është se çfarë ndodh me këta njerëz. Janë larguar gratë më dhunë," u shpreh gazetarja.

Musai shtoi se edhe gratë e lagjes "5 Maji" të cilat ishin në mbrojtje të shtëpive të tyre janë larguar me dhunë nga forcat e policisë.

Pavarësisht se gazetarja ishte e identifikuar me logon e Ora News dhe ishte në krye të detyrës, shprehu se "u dhunua në mënyrën më të shëmtuar dhe nuk i ka ndodhur më parë gjatë gjithë karrierës televizive që të largohet me forcë nga vendi i punës."

*Gazetarja pranon të dalë nga banesa, por duke vazhduar filmimin. Në mënyrë absurde një efektiv i policisë bashkiake të kryeqytetit tërheq gazetaren, duke i mbyllur telefonin në transmetim live madje duke ia hedhur dhe dëmtuar pajisjen."*¹

Në bazë të nenit 63/4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë "Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij" si dhe në bazë të nenit 19 gërma "b" të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, nga ana jonë është kryer hetimi administrativ në vijim i rastit, duke iu adresuar organeve kompetente.

Gjatë korrespondencës që kemi pasur me institucionet e varësisë së Ministrisë së Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, si dhe Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, rezultoi se në këtë ngjarje nuk ishin të përfshirë punonjës të policisë së shtetit. Vlen të theksohet se këto struktura kanë qenë të hapura për bashkëpunim dhe komunikim si me institucionin e Avokatit të Popullit, po ashtu edhe me vetë gazetaren.

Në deklaratimet e dhëna nga gazetarja S.M në institucionin tonë referohet si më poshtë vijon:

"Në datë 9 shkurt, në orët e para të mëngjesit, kemi qenë së bashku me grupin e xhiritimit në zonën e 5 Majit në Njësinë Administrative nr.4 Tiranë, pas njoftimit

¹ <https://www.oranews.tv/vendi/tensionet-te-5-maji-gazetarja-e-ora-nees-largohet-me-force-nga-policia-tek-i1029015>

për prishjen e banesave dhe lajmërimin të banorëve për ta publikuar lajmin në media.

Në momentin që erdhi policia në njërin nga shtëpitë, unë kam qenë brenda dhe njëkohësisht live, duke përcjellë pamje të drejtëpërdrejta me anë të aparatit tim celular.

Në banesë kanë hyrë punonjësit e IMT-së të identifikuar dhe të paidentifikuar, forcat shqiptonja dhe forcat e rendit dhe punonjës të policisë bashkiake për të larguar banorët që ishin brenda.

Gjatë kohës që isha live njëri nga punonjësit e Policisë Bashkiake më kërkoi të largohem. Pa e kundërshtuar i kërkova të mos më prekë dhe të mos më pengojë në ushtrimin e detyrës, pasi do të dal vetë.

Gjithashtu, i kam vënë në dijeni punonjësit e policisë bashkiake që jam gazetar, por ndërkohë isha edhe e identifikuar me një veshje ku dukej qartë edhe logoja e televizionit ku punoja.

Më pas, një nga punonjësit IMT-së së bashkisë i cili ishte i veshur civil më kap telefonin dhe ma lëshoi në tokë. Në atë moment është bërë edhe shkëputja ime live nga transmetimi.

Teksa po përpiqesha të merrja në telefon, turma e policëve bashkiakë më shtyn në drejtim të shkallëve të objektit ku ndodhesha.

Në atë moment kam reaguuar, duke i thënë me të madhe punonjësve të policisë: Çfarë jeni duke bërë se jam media? Duke ua rikujtuar.

Më pas, teksa dola nga banesa punonjësi i IMT-së, Erald Tusha, i ka kërkuar një polici bashkiak që të më largojë që aty.

Gjatë kësaj kohe teksa polici bashkiak më largonte duke ushtruar force, më mbante për krahu.

Lidhur me këtë fakt kam bërë edhe një kallëzim penal pranë organit të akuzës dhe shpresoj që personat përgjegjës të marrin ndëshkimin sipas ligjit dhe raste të tilla të mos përsëriten më, as ndaj meje e as ndaj kolegëve të mi, të cilët si mision kanë transmetimin dhe raportimin e lajmit.”

Në vijim, kemi adresuar ngjarjen me shkresën nr.K2/I4-5prot., datë 25.03.2022, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ku kemi kërkuar informacion lidhur me kallëzimin e paraqitur nga shtetasja S.M.

Prokuroria me shkresën nr.462/1 prot., datë 01.04.2022 na konfirmon se në datën 16.02.2022 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë është regjistruar materiali kallëzues me nr.2230, në bazë të kallëzimit të bërë nga ana e shtetasës S.M ndaj punonjësve të policisë bashkiake dhe inspektorëve në terren.

Pas shqyrtimit të akteve të referuara, nga ana e prokurorit të çështjes, më datë 22.02.2022 është marrë vendimi për mosfillimin e procedimit penal. Ky vendim është ankimuar nga shtetasja Dema në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ende nuk ka një vendim përfundimtar.

Ndërkohë, Policia Bashkiake me shkresën nr.12071/1 prot., datë 31.03.2022 na ka kthyer përgjigje se shërbimet e Policisë Bashkiake kanë zbatuar konform ligjit, detyrat e ngarkuara për të ruajtur perimetrin e përcaktuar gjatë ndërhyrjes për shembjen e objekteve në zonën e “5 Majit”, ashtu edhe me mbështetjen e Inspektoratit për Mbrojtjen e Territorit, për realizimin e detyrës, duke bërë të mundur parandalimin e ngjarjeve me pasoja për jetën e njerëzve.

Pavarësisht zgjidhjes dhe vendimmarrjes së organeve gjyqësore për këtë çështje penale, nëse janë konsumuar apo jo elementet e figurës penale, vlerësojmë se sjellja dhe trajtimi me dinjitet i gazetarëve mbetet një sfidë në realitetin shqiptar, në veçanti nga punonjësit e strukturave shtetërore.

Konstatojmë se në këtë rast ka elemente të cenimit të të drejtave të rëndësishme të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si ajo e lirisë së shtypit dhe e drejta e informimit. Për këtë arsye, lind nevoja e trajtimit të këtij rasti si rast përgjithësues.

Avokati i Popullit në deklaratat e tij të herëpashershme, por edhe në disa rekomandime, të bëra publike, është shprehur për mbrojtjen e lirisë së shtypit dhe gazetarëve, si dhe të drejtën e qytetarëve për të qenë të informuar në kohë reale për ngjarjet me interes publik. Po ashtu, institucioni ynë i ka kushtuar një rëndësi të veçantë të drejtave të gazetarëve dhe ka ndërtuar një bashkëpunim të ngushtë me mediat edhe në kuadrin e “aleancës kundër gjuhës së urrejtjes”.

Kështu, është tepër e rëndësishme që institucionet ta respektojnë misionin informues të gazetarëve dhe sigurisht t’i japin fund kulturës së intimidimit apo sulmeve mbi gazetarët. Nga ana tjetër, është e nevojshme që edhe komuniteti i medias të kuptojë rëndësinë e misionit të vet e ta ruajë atë nga shpërdorimi e keqpërdorimi.

Rëndësia e këtyre të drejtave demonstron edhe nga moria e instrumenteve apo organizmave ndërkombëtare që e kanë trajtuar.

Gazetarët duhet të ndihen të sigurt për të punuar. Pa lirinë e medias, nuk ka shoqëri të lirë dhe demokratike. Liria e shprehjes dhe liria e medias janë standardet kryesore me të cilat vlerësohet përparimi i vendeve kandidate drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Angazhimi i autoriteteve shqiptare duhet të garantojë dhe masat mbrojtëse në mënyrë që punonjësit e medias dhe gazetarët të punojnë në mjedise të sigurta. Në këto autoritete përfshihen jo vetëm autoritetet policore, por edhe autoritete e agjenci të tjera që ushtrojnë veprimtari ligjzbatuese si institucionet e pushtetit lokal.

Standardet Ndërkombëtare për mbrojtjen e gazetarëve dhe detyrimet pozitive për shtetet anëtare të Këshillit të Evropës (KE) rrjedhin nga neni 10 i Konventës

Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të mbrojtur gazetarët dhe lirinë e shprehjes, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe instrumente si Platforma për Mbrojtjen e Gazetarisë dhe Sigurinë e Gazetarëve.

“Paketa e Zgjerimit për vitet 2020, 2021, 2022 tregon qartazi nevojën për të pasur zero tolerancë ndaj frikësimeve dhe kërcënimeve kundrejt gazetarëve dhe medias në rajon. Është thelbësore që gazetarët në Shqipëri të jenë të aftë ta bëjnë punën e tyre pa qenë të kërcënuar nga dhuna, sulmet apo intimidimet, për të siguruar që qytetarët kanë akses ndaj informacionit”, thuhet në reagimin e KE.²

Gjatë prezantimit të Paketës së Zgjerimit 2022, fusha ku Shqipëria vlerësohet se “nuk ka bërë përparim”, është ajo e lirisë së shprehjes, ku theksohet se “ndërthurja e interesave të biznesit dhe politikës vazhdoi të pengonte pavarësinë e medias dhe cilësinë e gazetarisë”. Sipas raportit: “Atmosfera e sulmeve verbale, fushatave të përbaltjes dhe akteve të intimidimit ndaj gazetarëve që raportojnë për sundimin e ligjit, korrupsionin dhe çështjet e drejtësisë, nuk janë përmirësuar.” Po ashtu, theksohet se “mbetet e rëndësishme të sigurohet që media të ketë qasje të drejtpërdrejtë dhe transparente në institucionet qeveritare dhe aktivitetet e tyre”³.

Gjithashtu, qëndrim publik lidhur me përshkallëzimin e situatës në dhjetor të vitit 2020, ka mbajtur edhe Komisioneri i Lartë i Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut, Znj. Dunja Mijatovic⁴, e cila ndër të tjera është shprehur se është e shqetësuar në lidhje me ndalimin dhe sulmet e pretenduara ndaj disa gazetarëve që mbulojnë demonstratat.⁵

Sipas znj.Mijatovic, *“sulmet ndaj gazetarëve përbëjnë një shkelje serioze të lirisë së shtypit dhe të drejtës për t’u informuar. Autoritetet duhet të sigurojnë që gazetarët mund të vazhdojnë të informojnë qytetarët pa frikë nga kërcënimet ose aktet e dhunës”*.

Ndërkohë, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka shfaqur një sërë shqetësimesh lidhur me kufizimin e lirisë së medias në vend, duke përgatitur edhe disa raporte për këtë fushë.

Në forumin e tetë për Zhvillimin e Medias, Kryetari i OSBE-së në Shqipëri, ambasadori Vincenzo del Monaco renditi disa shqetësime, ndër të cilat edhe

² Shih <https://www.alb365.al/v1/2020/12/14/ke-demon-dhunen-ndaj-gazetareve-jo-sulme-dhe-intimidime/?fbclid=IwAR2IC7e3yYkZMËSVOVp95Z7jz5jYYBsmkB10NCEe-JCVv2J4A-vhGBJeIT8>

³ https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

⁴ *“Autoritetet shqiptare duhet të tregojnë përmajtje në menaxhimin policor të demonstratave dhe të sigurojnë hetime të hollësishme, të pavarura dhe efektive për të gjitha pretendimet e përdorimit të tepruar të forcës. Ndërsa e drejta për mbledhje paqësore mund të kufizohet për të mbrojtur shëndetin publik, autoritetet duhet të mbështesin parimet e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit në të gjitha rrethanat. Policia gjithashtu duhet të bëjë dallimin midis individëve të përfshirë në dhunë dhe atyre që demonstrojnë në mënyrë paqësore dhe të përmbahen nga përdorimi i rëndë ose pa kriter i forcës.”*

⁵ Për më tepër, mund të shihet Deklarata e plotë e datës 16.12.2020 *“Albanian authorities must prevent further police violence and uphold the right to freedom of peaceful assembly”*.

<https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/albanian-authorities-must-prevent-further-police-violence-and-uphold-the-right-to-freedom-of-peaceful-assembly>

fushatën e sulmeve ndaj gazetarëve dhe problematika të tjera me të cilat përballlet sot media.

“Liria e shprehjes është fusha ku ne kemi parë më pak progres, dhe kjo mbetet një shqetësim për ne, mbetet shqetësim që ne e shohim në të gjithë rajonin në të njëjtën atmosferë të sulmeve verbale, të fushatave të njëjta dhe të sulmeve të gazetarëve që nuk janë përmirësuar dhe ky konteskt nuk ka hasur përmirësim. Ne shohim që ndërhyrja e biznesit në media e ndikon, pengon, krijon pengesa në cilësinë e gazetarisë dhe gazetarëve.”

Teresa Ribeiro, përfaqësuesja e OSBE-së për lirinë e medias është shprehur në veçanti edhe për shuarjen e zërave kritikë.

Avokati i Popullit vlerëson se dhuna ndaj gazetarëve, fizike apo psikologjike, rrezikon të drejtat për integritet personal, jetën dhe lirinë e mendimit dhe të shprehjes. Gjithashtu, mungesa e kujdesit të duhur në hetimin, ndjekjen dhe ndëshkimin e të gjithë personave apo strukturave që janë përgjegjës, mund të rezultojë në një shkelje shtesë të të drejtave për akses në drejtësi dhe garancitë gjyqësore të të prekurve dhe anëtarëve të familjeve të tyre.

Ushtrimi efektiv i këtyre të drejtave përfshin detyrime pozitive dhe negative për shtetet. Kështu, në se njerëzit përballen me situata me ndjeshmëri të veçantë, dhe nuk janë ndërmarrë masa nga shtetet për të parandaluar veprimet që ndikojnë në ushtrimin e të drejtave, vetë shtetet mund të mbahen përgjegjës.⁶

Sa u përket detyrimeve negative, në zbatim të parimeve të së drejtës ndërkombëtare, shteti është përgjegjës për të gjitha aktet dhe veprimet në të cilat agjentët e tij marrin pjesë në ushtrimin e detyrave të tyre, përfshirë edhe rastet dhe situatën kur tejkalojnë kufijtë e autoritetit të tyre.⁷

Në respektim të lirisë së shprehjes, Zyra e Raportuesit Special të OKB-së për Lirinë e Opinionit dhe Shprehjes ka theksuar rëndësinë e tre detyrimeve pozitive që burojnë nga të drejtat për jetën, integritetin personal dhe lirinë e shprehjes. Konkretisht, detyrimi për të parandaluar, detyrimi për të mbrojtur dhe detyrimi për të hetuar, provuar dhe ndëshkuar penalisht ata që janë përgjegjës për këto krime.⁸ Siç ka treguar Zyra e Raportuesit Special, këto detyrimet janë plotësuese të njëra-tjetrës: në mënyrë që të jetë e lirë, e fortë dhe të ekzistojë debati i

⁶ IACHR. [Report on Citizen Security and Human Rights](#). OEA/Ser.L/V/II Doc. 57. December 31, 2009. Para. 38.

⁷ I/A Court H.R. *Case of the “Mapiripán Massacre” v. Colombia*. Judgment of September 15, 2005. Series C No. 134. Para. 108; I/A Court H.R. *Case of the “Pueblo Bello Massacre” v. Colombia*. Judgment of January 31, 2006. Series C No. 140. Para. 111.

⁸ United Nations (UN) Special Rapporteur on Freedom of Opinion and Expression, Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE) Representative on Freedom of the Media, Organization of American States (OAS) Special Rapporteur on Freedom of Expression and African Commission on Human and Peoples’ Rights (ACHPR) Special Rapporteur on Freedom of Expression and Access to Information. June 25, 2012. [Joint Declaration on Crimes Against Freedom of Expression](#).

pakufizuar demokratik, dhuna ndaj gazetarëve duhet të luftohet përmes një politike gjithëpërfshirëse të parandalimit, mbrojtjes dhe ofrimit të drejtësisë.

Zyra e Raportuesit Special ka theksuar në vijimësi përgjegjësinë e zyrtarëve qeveritarë për të mbajtur vazhdimisht qëndrime publike që nuk i vënë gazetarët në rrezik të rritur të dhunës. Ai ka kujtuar, ndër të tjera, se masa e thjeshtë, por shumë efektive mbrojtëse përbëhet nga qëndrimet e autoriteteve më të larta të shtetit që njohin në mënyrë të qëndrueshme, të qartë, publike dhe të vendosur legjitimitetin dhe vlerën e profesionit të gazetarit, edhe kur informacioni i shpërndarë mund të rezultojë kritik ose i papërshtatshëm për interesat e qeverisë. Në mënyrë të ngjashme, është thelbësore që autoritetet të dënojnë me forcë sulmet e kryera kundër punonjësve të medias dhe inkurajojnë autoritetet kompetente të veprojnë me rigorozitet dhe shpejtësi për të hetuar ngjarje të tilla dhe për të ndëshkuar përgjegjësit e tyre.⁹

Sulmet kundër gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias përbëjnë shkelje veçanërisht serioze të të drejtave të njeriut, sepse ato synojnë jo vetëm individët, por privojnë të tjerët nga e drejta e tyre për të marrë informacion, duke kufizuar kështu debatin publik, i cili është në zemër të demokracisë pluraliste. Në përgjigje të nivelit alarmant dhe të papranueshëm të kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe aktorëve të medias në Evropë, dhe duke pasur parasysh efektin dëmtues në funksionimin e shoqërisë demokratike, në Prill 2016, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës miratoi Rekomandimin CM / Rec (2016) 4 për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias.¹⁰

Rekomandimi është instrumenti i vetëm ndërkombëtar që siguron udhëzime shteruese për shtetet anëtare për të vepruar në fushat e parandalimit, mbrojtjes, ndjekjes penale, promovimit të informacionit, edukimit dhe ngritjes së vetëdijes me synimin për të siguruar mbrojtjen efektive të gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve dhe aktorët e medias.

Gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias, jeta ose integriteti fizik i të cilëve janë në një rrezik real dhe të menjëhershëm duhet të kenë qasje të menjëhershme në autoritetet e zbatimit të ligjit dhe/ose në një mekanizëm të veçantë mbrojtjeje/sigurie.

Shtetet Anëtare duhet të marrin parasysh natyrën specifike dhe vlerën demokratike të rolit të luajtur nga gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias në veçanti kontekste, të tilla si në kohë krize, gjatë periudhave të zgjedhjeve, në demonstrata publike dhe në zona konflikti. **Në veçanti, në këtë kontekst është e rëndësishme që autoritetet e zbatimit të ligjit të respektojnë rolin e**

⁹ Annual Report 2010. Office of the Special Rapporteur for Freedom of Expression.

¹⁰ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka pranuar në mënyrë të përsëritur që individë, organizata të shoqërisë civile, sinjalizues dhe akademikë, përveç gazetarëve profesionistë dhe medias, të gjithë mund të japin kontribute të vlefshme në debatin publik, duke luajtur kështu një rol të ngjashëm ose ekuivalent me atë të luajtur tradicionalisht nga media e institucionalizuar dhe gazetarët profesionistë.

gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias që mbulojnë demonstrata dhe ngjarje të tjera. Kartat e shtypit ose sindikata, akreditimi përkatës dhe shenjat gazetareske duhet të pranohen nga autoritetet shtetërore si letra kredenciale, dhe kur nuk është e mundur që gazetarët ose aktorët e tjerë të medias të prodhojnë dokumentacion profesional, autoritetet shtetërore duhet të bëjnë çdo përpjekje të mundshme për të përcaktuar statusin e tyre. Dialogu midis autoriteteve shtetërore dhe organizatave të gazetarëve inkurajohet për më tepër për të shmangur fërkimet ose përplasjet midis policisë dhe anëtarëve të medias.

Në çështjen *Pentikäinen kundër Finlandës*, Gjykata nënvizoi rolin thelbësor të mediave në sigurimin e informacionit mbi trajtimin e demonstratave publike nga autoritetet dhe ndalimin e çrregullimeve. Duke theksuar funksionin “*vëzhgues*” të mediave, gjykata deklaroi se çdo përpjekje për të hequr gazetarët nga skena e demonstratave duhet t'i nënshtrohet një kontrolli të rreptë.

Sipas qasjes së Gjykatës, çdo situatë e tillë duhet të shihet në dritën e rrethanave të secilës çështje të veçantë. Elementet që do të merren në konsideratë nga gjykata kombëtare përfshijnë: (a) nëse autoritetet kishin parandaluar ose penguar qëllimisht mediat nga mbulimi i demonstratës/ngjarjes në një përpjekje për të fshehur nga vështrimi publik veprimet e policisë/organeve të tjera publike; (b) nëse bindja ndaj urdhrave të autoriteteve do të kishte penguar plotësisht përfaqësuesit e mediave të kryejnë detyrat e tyre profesionale. Gjykata, megjithatë, gjithashtu deklaroi se gazetarët duhet t'i binden urdhrave të ligjshëm të policisë dhe nuk mund të kërkojnë imunitet nga përgjegjësia penale për arsyen e vetme që vepra penale (nëse ka) ishte kryer gjatë kryerjes së funksioneve të tyre gazetareske.¹¹

Duke pasur parasysh rolin thelbësor të gazetarëve në përcjelljen e informacionit për publikun dhe mbajtjen e përgjegjësisë nga autoritetet, veçanërisht në kontekste të ndjeshme, është e domosdoshme që autoritetet shtetërore të mos ndërhyjnë në mbulimin nga ana e medias të ngjarjeve që kanë implikime të rëndësishme për funksionimin e sistemeve demokratike. Si rrjedhojë, gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias kanë të drejtë të fotografojnë/demonstrojnë filmime, duke përfshirë trajtimin policor të trazirave dhe se **pajisjet e tyre nuk duhet të sekuestrohen.**

Agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të jenë të vëmendshme ndaj shenjave dhe kredencialeve gazetareske. Për më tepër, mungesa e tyre nuk duhet të përdoret si pretekst për kufizime të padrejta në aktivitetet gazetareske. Kur gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias nuk janë në gjendje të prodhojnë dokumentacion që tregon statusin e tyre, autoritetet duhet të përpiqen ta verifikojnë atë me mjete të tjera, për shembull, duke konsultuar organizata të besueshme mediatike dhe organizata profesionale të gazetarëve që mund të konfirmojnë statusin e gazetarit. Trajnimi/dialogu i koordinuar midis medias dhe policisë është i rëndësishëm për

¹¹ Shif *Pentikäinen v. Finland* (GC), nr. 11882/10, 20 Tetor 2015, §§ 89, 91.

të kuptuar përgjegjësitë dhe kufizimet e njëri-tjetrit dhe për këtë arsye sigurojnë besim dhe marrëdhënie të mira pune.

Sipas Indeksit Botëror të Lirisë së Shtypit për vitin 2022 theksohet për Shqipërinë se pavarësia editoriale dhe integriteti fizik i gazetarëve janë në rrezik.

Sipas Indeksit të ri Botëror të Lirisë së Shtypit nga Reporterët pa Kufi (RSF) i publikuar së fundmi, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi arritën përparim të lehtë në lirinë e medias në Ballkanin Perëndimor krahasuar me një vit më parë.

Indeksi krahason nivelin e lirisë së shtypit që gëzojnë gazetarët dhe mediat në 180 vende dhe territore. Renditja e Indeksit bazohet në një pikë që varion nga 0 në 100 që i caktohet çdo vendi ose territori, ku 100 është rezultati më i mirë i mundshëm (niveli më i lartë i mundshëm i lirisë së shtypit) dhe 0 më i keqi. I gjithë Ballkani Perëndimor është në kategorinë e vendeve me liri “problematike” të shtypit.

Referojmë se Shqipëria ka pësuar përkeqësim sa i përket fushës së lirisë në vitin 2022. Vlen të përmendet fakti se krahasuar me një vit më parë, kur arriti rezultatin 69.41 dhe renditej në vendin e 83-të, Shqipëria pësoi përkeqësim. Me pikësimin 56.41, ky vend renditet më i ulëti në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Krahas pavarësisë editoriale që kërcënohet përmes institucioneve shumë të politizuara të rregullimit të medias dhe menaxhimit të medias publike, vlerëson RSF, liria e shtypit është minuar nga krimi i organizuar, dështimi i shtetit për të ofruar mbrojtje dhe madje edhe dhuna policore.¹²

Në rastin në trajtim të gazetares S.M e cila nuk është lejuar të filmojë dhe të vijojë punën e saj në terren, **për më tepër i është thyer edhe telefoni dhe është larguar me forcë nga vendi i ngjarjes**, është një rast ku haptazi nga punonjësit e IMT-së dhe të policisë bashkiake shkelen të drejtat e lirisë së medias. Autoritetet duhet të tregojnë vetëpërmbytje, të respektojnë ushtrimin e profesionit të gazetarisë dhe raportimin e ngjarjeve nga gazetarët, veçanërisht gjatë ngjarjeve të tilla kur prishja e banesave paraqet ndjeshmëri të lartë për vetë shtetasit. Për më tepër, organet ligjzbatuese duhet të tregohen të kujdesshëm gjatë punës së tyre, duke respektuar dinjitetin dhe integritetin e çdo banori, si dhe të gazetarëve që transmetojnë nga terreni situatat.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ, çojmë se veprimet e punonjësve të Policisë Bashkiake dhe të IMT-së kanë penguar ushtrimin e profesionit të gazetarit, i cili është i garantuar me ligj.

¹² Në çështjen e mbështetjes dhe respektimit të autonomisë së medias dhe rolit të tyre në mbajtjen e qeverisë dhe politikanëve përgjegjës, sipas RSF, situara nuk është mjaft e mirë. Gazetarët kritikë ndaj qeverisë përballen me sulme të rregullta politike që synojnë t'i diskreditojnë ata dhe ata kanë vështirësi në aksesin e informacionit publik, gjë që rrezikon kufizime të mëtejshme nga një centralizim i fundit i komunikimit të qeverisë.

Shumica e mediave private janë në pronësi të kompanive që kanë disa lidhje me politikanë dhe ndërsa ka qindra media online në vend, vetëm një pakicë e vogël ka një model të qëndrueshëm biznesi me financim transparent, paralajmëroi RSF.

Gjithashtu, dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj se gjatë hetimit administrativ, bashkëpunimi me Avokatin e Popullit dhe njëkohësisht kthimi i përgjegjeve të plota dhe shteruese për sa kërkohet, si dhe shmangia e burokracive nga institucionet në varësi të Bashkisë Tiranë, duhet të konsiderohen parime të punës së përbashkët në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, *si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, gjykon se bazuar në evidentimin e problematikës të lartpërmendur, lind nevoja e një reagimi të fortë dhe në vijimësi nga strukturat e Bashkisë Tiranë, për të garantuar respektimin e ushtrimit të profesionit të gazetarisë dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

- *Analizimin me prioritet të rastit lidhur me mënyrën e trajtimit të gazetares S.M gjatë prishjes së banesave në lagjen “5 Maji”, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe njëkohësisht duke marrë masat administrative respektive ndaj punonjësit të IMT-së dhe atyre të policisë bashkiake.*
- *Marrjen e masave të nevojshme nga Bashkia Tiranë dhe Inspektorati për Mbrojtjen e Territorit të kësaj bashkie për të garantuar të drejtën e ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve nga gazetarët e terrenit, të pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre.*
- *Marrjen e masave për të mos penguar gazetarët në ushtrimin e të drejtës së informimit.*
- *Marrjen e masave të nevojshme për trajnimin e punonjësve të policisë bashkiake dhe punonjësve të IMT-së, në kuadër të respektimit të integritetit dhe dinjitetit personal të gazetarëve dhe lirisë së shprehjes, me qëllim mospërsëritjen e rasteve të ngjashme në të ardhmen.*

- *Marrjen e masave për sigurimin e një bashkëpunimi më të mirë të Bashkisë Tiranë dhe strukturave të saj të varësisë me institucionin e Avokatit të Popullit, në kthimin e përgjigjeve shteruese, si dhe duke shmangur burokracitë.*

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA